

Charité | KVZ | Augustenburger Platz 1 | 13353 Berlin

Drejtuar prindërve të

**Charité - Universitätsmedizin Berlin
 Einladungs- und Rückmeldewesen
 für Kinder-Früherkennungsuntersuchungen**

 Telefon (030) 450 566 022
 Fax (030) 450 566 988
 E-Mail zentralestelle@charite.de
 Internet https://kindervorsorge.charite.de

Berlin, tt.mm.jjjj

 Screening-ID: 
 000 000 000 000
Kujtesë për UX e fëmijës tuaj Xxxx

Të dashur prindër, të dashur kujdestarë ligjorë,

a keni pasur mundësinë të lini një takim për UX-in për Xxxx, apo e keni kryer tashmë atë?

Ne, si zyrë qendrore, përgjegjëse për ftesat dhe konfirmimet, grumbullojmë të dhënat mbi pjesëmarrjen në ekzaminimet për konstatimet e hershme, në mënyrë qendrore për Berlin-in dhe për fat të keq, ne nuk kemi marrë ende ndonjë njoftim në lidhje me këtë. Kjo mund të ketë arsye të ndryshme:

- Kur ekzaminimi është kryer më herët se 10 ditë më parë, mund të ketë ndonjë gabim në komunikimin mes mjekut tuaj pediatër të Berlin-it dhe midis nesh. Në një rast të tillë, ju lutemi të na njoftoni shkurtimisht përmes telefonit, faksit apo e-mailit.
- Nëse ekzaminimi është kryer tashmë ose ju keni lënë tashmë një takim, atëherë ne ju urojmë juve dhe fëmijës tuaj gjithë të mirat në të ardhmen dhe konsiderojeni këtë letër si të pagënë. Ne shpresojmë, se do e marrim së shpejti konfirmimin për ekzaminimin.
- Në rast se ju nuk keni arritur të lini një takim deri tani, ne jemi të vetëdijshëm, që me fëmijë të vegjël një gjë e tillë ndodh edhe të harrohet herë pas here - ndaj ju lutemi të kontaktoni sa më parë mjekun tuaj pediatër me qëllimin që UX të kryhet sa më parë, përpara datës tt.mm.jjjj.

Në rast se mjeku juaj pediatër nuk do të ketë më takime, ju do të gjeni në faqen tonë të internetit informacione të mëtejshme se si të kërkonti një mjek, si edhe një listë me kontakte të klinikave që ofrojnë takime të shpejta.

Është e rëndësishme të konstatohet sa më herët, nëse zhvillimi i Xxxx rrjedh normalisht apo nëse ekziston ndonjë rrezikim në zhvillimin e tij fizik apo mendor. Vetëm në rastin e njohjes në kohë të këtyre rreziqeve mund të ketë efekt terapia e përshtatshme. Ekzaminimet (U1-U9) duke nisur nga viti 2017, shërbejnë gjithashtu për njohjen e anomalive të sjelljes në zhvillimin psikosocial, sepse edhe këtu trajtimi i hershëm është më i miri për fëmijën tuaj.

Prandaj: Shfrytëzoni me patjetër ofertat e ekzaminimeve për zbulimin e hershëm në të mirën e fëmijës tuaj!

Nëse pak para përfundimit të kohës për ekzaminimet, ne nuk na është paraqitur vërtetimi për pjesëmarrjen e fëmijës dhe mjekut tuaj pediatër, atëherë ne jemi të detyruar të njoftojnë Zyrën Shëndetësore të Qarkut tuaj. Punonjësit ju kontaktojnë juve personalisht dhe ju ofrojnë, në rast se është e nevojshme, një vizitë në shtëpi dhe konsultë/mbështetje. Ju lutemi të na njoftoni vetëm mbi ekzaminimet e kryera dhe jo mbi takimet e lëna, sepse vetëm ekzaminimet e kryera kanë ndikim në procedurë (takimet jo).

Me respekt

Ekipi juaj i zyrës qendrore të entit, përgjegjës për ftesat dhe konfirmimet e detyrueshme për ekzaminimet me qëllim konstatimi të hershëm.